



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28.1 të Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **27 tetor 2022 (e enjte) me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 29 shtator 2022;
2. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
3. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2021/2022 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2022/2023;
4. Shqyrtimi i Informatës nëntëmujore lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë teatrin, bibliotekën dhe muzeun;
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022;
6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për formim të komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës;
7. Shqyrtimi i Raportit të menaxhimit të performancës dhe grantit të bazuar në performancë për vitin 2021;
8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirim nga taksa komunale për projektet investive të KEDS-it gjatë vitit 2022;
9. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë;
10. Të ndryshme.

Melihate Basholli-Latifi


Kryesuese e Kuvendit të Komunës

